



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.730/11 prot.

Datë 17.04.2026

**V E N D I M**

**Nr. 513/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 17.04.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 439/2026, datë 30.03.2026 për procedurën e prokurimit “*E hapur, e thjeshtuar*”, me nr. REF-77629-02-26-2026, me objekt: “*Shërbimi i fiskalizimit të faturave*”, me fond limit 2,486,000.00 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 09-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Kreatx” SHPK me me NUIS L12121023B dhe adresë: Rruga “Robert Shvare”, godina “Niku Constraksiun”, kati nr.1 teknik, hyrja nr.2, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A Rajoni Nr.1, Rruga: “Boris Plumbi”, Nr. 20, Korçë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Rrethanat e çështjes*

I.1. Në datë 30.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 439/2026, ku vendosi:

#### **Vendosi**

- 1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK për procedurën e prokurimit prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-77629-02-26-2026, me objekt: “Shërbimi i fiskalizimit të faturave”, me fond limit 2,486,000.00 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 09-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A.*
- 2. Autoriteti kontraktor, të kryejë sqarimet dhe modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.*
- 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Kreatx” SHPK.*
- 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr. 355/24 prot., datë 02.04.2026, protokolluar me tonën nr.730/8 prot., datë 07.04.2026, autoriteti kontraktor informon KPP-në se ka zbatuar Vendimin Nr. 439/2026, datë 30.03.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

### **II**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

#### **Arsyeton**

II.1. Me shkresën nr. 355/24 prot., datë 02.04.2026, protokolluar me tonën nr.730/8 prot., datë 07.04.2026, autoriteti kontraktor informon KPP-në se ka zbatuar Vendimin Nr. 439/2026, datë 30.03.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.2. Komisioni i Prokurimit Publik, bëri verifikimet përkatëse në sistemin e prokurimeve elektronike të Agjencisë së Prokurimit Publik, lidhur me zbatimin e vendimit Nr.439/2026, datë 30.03.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e mësipërme të prokurimit. Nga ky verifikim, rezultoi se, autoriteti kontraktor ka sqaruar dhe modifikuar dokumentat e tenderit të mësipërm, në përputhje me konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik në këtë vendim.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-77629-02-26-2026, me objekt: “Shërbimi i fiskalizimit të faturave”, me fond limit 2,486,000.00 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 09-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

